



Akt Normativ nr. 4, datë 16.03.2020

Në Fletoren Zyrtare nr. 38 u publikua Akti Normativ nr. 4, datë 16.03.2020 "Për disa shtesa në Aktin Normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19".

Akti normativ parashikon sa më poshtë:

- Individët të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për ndalimin e lëvizjes së këmbësoreve sipas orareve të caktuara, dënohen me gjobë në masën 10.000 lekë dhe me bllokim 3 muaj të automjetit privat, nëse e disponojnë një të tillë.
- Individët të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për kufizimin e lëvizjeve në parqe dhe zona urbane apo mjedise të tjera publike të hapura, dënohen me gjobë në masën 20.000 lekë dhe me bllokim 3 muaj të automjetit privat nëse e disponojnë një të tillë.
- Për individët të cilët në kushtet e shkeljeve sa më sipër, lëvizin me biçikletë, ciklomotor ose motomjet zbatohet dhe masa shoqëruese e bllokimit të mjetit lëvizës për 3 muaj.

Akti Normativ nr. 4 ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është me forcë dhe efekt të plotë.

Aktualisht ndalimi i lëvizjes së këmbësorëve fillon në orën 18:00. Për çdo ndryshim të mëvonshëm do t'ju përditësojmë sa më shpejt të jetë e mundur.



Normative Act no.4, dated 16.03.2020

On the Official Gazette no. 38 was published the Normative Act of the Council of Ministers no. 4, dated 16.03.2020, "On some additions to Normative Act no. 3, dated 15.03.2020 of the Council of Ministers "On special administrative measurements during the infection period caused by COVID-19".

The Normative Act provides for the following:

- Individuals, who fail to comply with the order issued by the competent authorities prohibiting the circulation of pedestrians in the defined time slots, shall be subject of a penalty ALL 10.000 and a three-month prohibition to use the private vehicle, if they do possess one.
- Individuals, who fail to comply with the order issued by the competent authorities restricting circulation in parks or urban areas or other open public spaces shall be subject of a penalty ALL 20.000 and a three-month prohibition to use the private vehicle, if they do possess one.
- For individuals, who under the conditions above-mentioned are cycling, ciclo-cycling or motorcycling the accompanying measure of a three-month suspension of the vehicle shall apply.

This Normative Act entered into force immediately and is in full force and effect.

Currently the pedestrians' circulation prohibition starts at 18:00 hours. For any subsequent changes, we will make sure to update you as soon as possible.